



## 7.10 PARAMETRAT E REDAKTUESIT TË REGJISTRIMIT

Hapësira e punës në ndërfaqen për katalogim mund të përshtatet.

Paracaktimi i parametrave të hapësirës së punës ndan dritaren e ndërfaqes në redaktues në nëndritaren e majtë dhe kujtesën e fragmenteve të regjistrimeve në nëndritaren e djathtë. Nëse dëshironi të ndryshoni hapësirën e punës, në mënyrë që, redaktuesi i regjistrimit të jetë në nëndritaren e djathtë, ndërkaq kujtesa e fragmenteve në nëndritaren e majtë, përzgjidhni metodën **Parametrat / Ndërro paraqitjen**.

Nëse dëshironi të keni vetëm nëndritaren e majtë, klikoni ikonën  (shigjeta në të djathtë) në skajin lëvizës, i cili përkufizon nëndritaret. Nëse klikoni ikonën  (shigjeta në të majtë), mbetet e hapur vetëm nëndritarja e djathtë.

Në rreshtin a parë të redaktuesit ndodhet numri identifikues i regjistrimit, ndërsa poshtë saj janë të renditura fushat në format të përmbledhur dhe me renditje në rritje. Në formatin e përmbledhur shfaqen vetëm numrat e fushave me vlerat numerike të treguesve, nëse ata ekzistojnë.

Nëse pranë emërtimeve të fushave, nënfushave, treguesve dhe kodeve në redaktues dëshironi të shihni edhe domethënien e tyre apo emërtimet, në menunë **Parametrat** klikoni:

- "Shfaq emrat e fushave dhe nënfushave"
- "Shfaq kuptimin e treguesve "
- "Shfaq kuptimin e kodeve " (parametri vlen edhe për kujtesën e fragmenteve të regjistrimeve)



**Këshillë:**

Nëse në menunë **Parametrat** nuk klikoni "Shfaq emrat e fushave dhe nënfushave ", emrat e fushave dhe nënfushave në redaktuesin e regjistrimit shfaqen vetëm kur të vendosni kursorin mbi fushën ose nënfushën e caktuar.

Nëse dëshironi, që në redaktues të jetë gjithmonë e hapur vetëm fusha e caktuar, në menunë **Parametrat** klikoni "Zgjero vetëm fushën e përzgjedhur".

Nëse dëshironi që regjistrimi në redaktues gjithmonë të hapet në formën e zgjeruar, në menunë **Parametrat** klikoni "Hap regjistrimin në formën e zgjeruar".

Të dhënat në nënfusha mund t'i vendosni edhe në dritare të veçantë, nëse në menunë **Parametrat** klikoni "Redakto në fushën e ndarë për futjen e të dhënave".

Nëse dëshironi, që në redaktues të theksohen ndryshimet, të cilat i bëni në regjistrim, në menunë **Parametrat** klikoni "Shfaq ndryshimet". Në këtë rast fushat, nënfushat dhe treguesit e ndryshuar janë me ngjyrë të **verdhë**.

Nëse dëshironi, që saktësinë e tekstit ta verifikoni në mënyrë automatike, në menunë **Parametrat** duhet të klikoni kutinë e zgjedhjes "Drejtshkrimori" (shih kap. 7.3.1.2).

Nëse figura e fushave dhe nënfushave në redaktues dëmtohet, atë mund ta freskoni duke përzgjedhur metodën **Pamja / Fresko redaktuesin**.